



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:255217
Datë: 24.10.2024
Numri i dokumentit: 06344366

CA.nr.11737/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Besnik Bislimaj e Enes Mehmeti - anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve (propozuesve) Xh.S. dhe S.S., të dy nga fshati..., komuna e Shtimes, të cilët me autorizim i përfaqëson av.B.Rr., nga Ferizaji, kundër të paditurit(kundërshtarit të sigurimit) B.B., nga Shtimja, rr.”...” p.nr., për shkak të anulimit të aktvendimit për trashëgimi dhe vërtetimit të së drejtës së pronësisë, me propozim për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur lidhur me ankesën e kundërshtarit të sigurimit të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - departamenti i përgjithshëm, C.nr.2024:255218, të datës 20.09.2024, në seancën e kolegjit, të mbajtur më datën **24.10.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurit (kundërshtarit të sigurimit) B.B. nga Shtimja, **PRISHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - departamenti i përgjithshëm, C.nr.2024:255218, i datës 20.09.2024, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me akvendimin e atakuar, C.nr.2024:255218, të datës 20.09.2024, në pikën *I (një)* të dispozitivit, e ka aprovuar si të bazuar propozimin e paditësve (propozuesve) Xh.S. dhe S.S., të dy nga fshati..., komuna e Shtimes. Në pikën *II (dy)* të dispozitivit e ka caktuar masën e sigurisë, duke ia ndaluar kundërshtarit të sigurimit B.B. tjetërsimin, ngarkimin apo shitjen e ngastrave kadastrale P-722217044-02794-0, ZK Jezerc, P-72217044-02795-0 ZK Jezerc, P-72217044-02796-0 ZK Jezerc dhe P-72217044-02797-0 ZK Jezerc. Në pikën *III (tre)* të dispozitivit, ka vendosur që procedura në këtë kontest të vazhdojë,

sipas rregullave të procedurës kontestimore si dhe sipas orarit dhe planit të punës së gjykatës, më gjerësisht si në aktvendimin e atakuar.

Kundër këtij aktvendimi kundërshtari i sigurimit në afatin ligjor ka parashtruar ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të *shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që të aprovohet ankesa e tyre dhe të ndryshohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu që të refuzohet propozimi për caktimin e masës së sigurisë, ose i njëjti të priset dhe çështja të kthehet në riprocedurë.

Propozuesit e sigurimit nuk kanë parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, e në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- *Ankesa e kundërshtarit të sigurimit është e themeltë.*

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësit (propozuesit) e masës së sigurisë me datën 18.09.2024, në gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur padi për anulimin e aktvendimit për trashëgimi dhe vërtetimin e së drejtës së pronësisë. Bashkë me padi kanë parashtruar edhe propozim për caktimin e masës së sigurisë, me të cilën kanë kërkuar që ti ndalohet kundërshtarit të sigurimit tjetërsimin, ngarkimin apo shitjen e ngastrave kadastrale të cekura në propozim.

Fillimisht gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit për masën e sigurisë pa e caktuar seancën dëgjimore, e ka aprovuar propozimin e paditësve (propozuesve) ashtu që me aktvendimin e atakuar C.nr.2024:255218, të datës 20.09.2024, e ka caktuar masën e sigurisë, duke kundërshtarit të sigurimit B.B. tjetërsimin, ngarkimin apo shitjen e ngastrave kadastrale P-722217044-02794-0, ZK Jezerc, P-72217044-02795-0 ZK Jezerc, P-72217044-02796-0 ZK Jezerc dhe P-72217044-02797-0 ZK Jezerc.

Në arsyetim të aktvendimit, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga provat e të cilat gjinden në shkresat e lëndë erdhi në përfundim se propozimi i propozuesve është për caktimin e masës së sigurisë është i bazuar në ligj. Tutje ka shtuar se sa i përket besueshmërisë së kërkesës përmes provave të bashkangjitura është provuar se paditësit janë djemtë e vajzave të trashëgimlënësit, ndërsa sa i përket rrezikshmërisë ka theksuar se pasi që prona udhëhiqet në emër të paditurit, atëherë vërtetohet se ekziston ky rrezik. Për mënyrën e vendosjes gjykata iu ka referuar nenit 297 par.1 dhe 2 të LPK-së

Gjykata e Apelit duke vlerësuar mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestuese nga ana e gjykatës së shkallës së parë, gjen se një përfundim i tillë është i pabazuar nuk ka mbështetje ligjore dhe aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 lidhur me nenin 160 par.4 dhe 5, dhe nenin 297 par.1, dhe 2 të LPK-së.

Aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 par.1 lidhur me nenin 160 par. 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktvendimi i atakuar ka të meta të atilla për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet. I njëjti aktvendim nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës. Po që se i referohemi arsyetimit të aktvendimit të atakuar, sipas vlerësimit të gjykatës ankimore, konstatohet se gjykata e shkallës së parë i është referuar deklaramit të propozueses dhe administrimit të provave të cilat i ka nxjerrë në shqyrtimin kryesor si dhe përshkrimit të dispozitave ligjore, pa dhënë arsyetim të qartë dhe konciz lidhur me kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë shfrytëzuar, arsye këto të cilat duhet ti përmbajë çdo vendim gjyqësor siç përcaktohet me dispozitat e nenit 160 par.4 dhe 5, e lidhur me nenin 175 të LPK-së.

Poashtu aktvendimi i atakuar është përfshirë me të meta thelbësore nga neni 181 par.1 lidhur me nenin 305 të LPK-së për arsye se gjykata e shkallës së parë ka caktuar masën e sigurisë duke e ndaluar tjetërsimin e paluajtshmërive kontestuese, pa iu dhënë mundësia kundërshtarit të sigurimit që të deklarohe lidhur me propozimin për masën e sigurisë , e që kjo është shumë e paqartë dhe e pazbatueshme, pasi që sipas dispozitave ligjore në fuqi nuk mund të caktohet masa e sigurisë po që se kundërshtari i sigurimit nuk ka pasur mundësinë që të deklarohe për propozimin e caktimit të saj. Me dispozitën e nenit 305 par.1 të LPK-së shprehimisht parashihet se *“Përveçse në rastet e përcaktuara me këtë ligj, masa e sigurimit nuk mund të caktohet po që se kundërshtari i sigurimit nuk ka pasur mundësinë që të deklarohe për propozimin e caktimit të saj”*. Ndërsa në par.2 të këtij neni përcaktohet se *“Propozimin për caktimin e masave të sigurimit gjykata, bashkë me shkresat që i janë bashkangjitur, ia dërgon kundërshtarit të sigurimit me njoftim se mund të paraqesë përgjigje të shkruar brenda afatit shtatë (7) ditor”*. Andaj sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, këto shkelje janë të natyrës së tillë për të cilat aktvendimi i atakuar duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përveç të lartcekurave, Gjykata e Apelit nuk e ka pranuar përfundimin dhe arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë, për shkak se propozuesit e kanë bërë të besueshme kërkesën për të drejtën subjektive dhe ekziston rreziku se pasuria e fituar gjatë bashkëjetesës faktike martesore mund të tjetërsohet. Me dispozitat e LPK-së, përkatësisht nenit 297 par.1 përcaktohet se *“Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij , dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshihjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*. Ndërsa par. 2 i këtij neni parasheh se *“Po që se nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, gjykata e cakton masën e sigurimit vetëm nën kushtet që propozuesi i sigurimit, brenda afatit të caktuar nga gjykata, ashtu siç parashihet me*

Ligjin mbi Procedurën Përmbartimore, jep garanci në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet palës kundërshtare me caktimin dhe ekzekutimin e masës së sigurimit” e që këto kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative.

Në këtë rast gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur për sigurimin e garancionit, pasi që në shkresat e lëndës askund nuk ekziston vendimi për deponimin e garancionit,. Sipas dispozitave të LPK-së gjykata është e obliguar të caktojë garancionin, e pastaj nëse ka kushte me kërkesën e palës dhe nëse ekzistojnë rrethanat mund ta lirojë nga pagesa e garancionit, andaj në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave ligjore.

Përveç kësaj gjykata e shkallës së parë, për mënyrën e vendosjes ku e ka caktuar masën e sigurisë, nuk e ka arsyetuar në mënyrë të duhur dy kushtet tjera lidhur me besueshmërinë e kërkesës apo të drejtës subjektive (*ku në dispozitiv dhe arsyetim ka prejudikuar zgjidhjen e çështjes kryesore*) dhe ekzistimin e rrezikut (*veç ka konstatuar që prona udhëhiqet në emër të paditurit*), por është mjaftuar vetëm duke iu referuar dispozitave të cekura të LPK-së.

Nga këto arsye gjykata e Apelit vendosi që çështjen ta kthejë në rishqyrtim me udhëzim që gjykata e shkallës së parë, të veprojë sipas udhëzimeve të gjykatës së shkallës së dytë, për të eliminuar shkeljet e lartcekura në atë mënyrë që në procedurën e vendosjes sipas propozimit të masës së sigurisë gjykata të veprojë në përputhje me dispozitat e LPK-së, sa i përket caktimit të masës së sigurisë. Në riprocedurë udhëzohet gjykata e shkallës së parë që për rastin në fjalë të ndërmer veprimet përkatëse procedurale përmes të cilave fillimisht duhet që kundërshtari i sigurimit të njoftohet dhe që të deklarohet për propozimin e caktimit të saj, e pastaj të caktojë seancën dëgjimore lidhur me këtë propozim. Pastaj gjykata e shkallës së parë udhëzohet që përmes provave të administruara të kufizohet vetëm në konstatimin e të provuarit të bazueshmërisë së kërkesës për caktimin e masës së sigurisë, në kuptim të dispozitave të lartcekura të LPK-së, pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen kryesore, të evitohet shkeljet e lartcekura procedurale, ashtu që vendimin të cilin do ta nxjerrë të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore, siç përcaktohet me dispozitat e nenit 160, e lidhur me nenin 175 të LPK-së. Në çdo rast veprimet dhe vendimet e gjykatës duhet të jenë në harmoni me dispozitat ligjore dhe standardet e gjykimit të drejtë.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 194, 208 dhe nenit 209 pika (d) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.11737/24, datë 24.10.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari
Arsim Hamzaj